

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi 39831200-8 - Detergjentë**
-

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,819,649 (dhjetë milion tetëqind nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Qendra Ekonomike e Arsimit (QEA)** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrat të grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr 14 prot 2 datë 19.01.2024 “për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”., si dhe

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në LigjinNr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si edhe VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Vendimit të Këshillit të Bashkiak nr.195 , datë 22.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2024-2026”,

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave

(INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Në vijim të Urdhërit nr 14 prot 2 datë 19.01.2024 “për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QAE-s Durrës”, grupi i punës, pasi u njoh me objektin e prokurimit, e rifilloi punën për hartimin e dokumentacionit duke pasqyruar në të dhe ndryshimet përkatëse.

Grupi i punës realizojë punë kërkimore mbi çmimet orientuese për mallrat, të cilat janë objekt prokurimi; duke u bazuar në Çmimet e Instatit, hetimin e tregut vendas si dhe kontratat e mëparshme, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, u testua tregu dhe çmimet e kontratave të mëparshme. Në fund të procesit u siguruan çmimet e vlerësuar për artikujt e ndryshëm të materialeve të pastrimit dhe dizinfektimit. Pas përlllogaritjes së preventivit të hartuar nga grupi i punës, pas studimit të tregut, vlera e përgjithshme rezulton të jetë **10,819,649** lekë pa Tvsh.

Në përfundim, pas hartimit të preventivit, për objektin e prokurimit me titull: “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”

Komisionibazuar në vlerën e preventivit vendosi që:

Vlera e fondit limit rezulton: **10,819,649** (dhjetë milion tetëqind nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë) **lekë pa TVSH.**

- **Afati kohor:**

Për realizimin e punës dhe zbatimin e kontratës duhet të jetë 12 muaj, ku furnizimi do të kryhet 1 (një) herë në muaj, në magazinën e Qendrës Ekonomike të Arsimit.

- **Garancia për mbulimin e difekteve, që mund të lindin gjatë realizimit të objektit të prokurimit, nga ana e operatorit ekonomik të jetë 12 muaj.**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 10’000’000 Lek

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qellim per te pare aftesite financiare te operateve ekonomin

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore per vitin 2021, ligjin nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kerkuara me siper, do te paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies se kontrates ose nese kerkohen sqarime nga A.K.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 4'000'000 lekë

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 40, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme _____ të lëshuar nga _____ (shënim- përcaktoni, **nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe _____.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- a.
- b.
- c.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:
- Drejtues mjeti 1 (një)
 - Punëtorë të thjeshtë 2 (dy)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj
Ndërsa për punonjësit e thjeshtë, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë.
Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

.....
.....

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht: duke qenë se do të nevojitet një mjet për shpërndarjen e mallrave për rrjedhojë nevojitet një drejtues mjeti. Gjithashtu për shpërndarjen e mallrave nevojiten 3 punëtor të thjeshtë për ngarkim shkarkimin e mallrave.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 3 persona** në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllëgaritur si më poshtë:

Bazuar në volumin e punës, dhe preventivin e hartuar duke qenë se mallrat që do të blehen, të cilët janë objekt prokurimi, do të shërbejnë për Qendrën Ekonomike të Arsimit Bashkia Durrës, për nga do të bëhet shpërndarja e tyre në magazinën qendrore 1 herë në muaj për periudhën totale 12 muaj, prandaj nevojitet një mjet, i cili duhet të jetë i pajisur me 1 (një) shofer/drejtues mjeti dhe 2 (dy) punëtorë për shkarkimin e mallit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti, që do të shërbejë për transportin e materialeve të pastrimit dhe dizinfektimit, me “masë maksimale të autorizuar” deri në 3.5 ton, në pronësi të tij ose të marra me qera, për transportin e mallrave, si objekt prokurimi. Kjo të vertetohet me dokumentacionet: leje qarkullimi, siguracionet e mjeteve, kolaudimin, foto të mjetit.

Për mjetet duhet të disponojë, dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit.

Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

(Shënim- Mjeti i kërkuar nga ana jone shërben për transportin e mallrave të kerkuara ne kete procedure).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuara) të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga

DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte;

- *Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001, i cili duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1, 2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar pajisjen e operatorit ekonomik me certifikatën 9001, për të vërtetuar se mallrat, si objekt i këtij prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe shpreh garancinë për to. Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë të tij.

- *Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001, i cili duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe pika 1, 2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” . Autoriteti Kontraktor kërkon pajisjen e operatorit ekonomik me këtë certifikatë, pasi duke qenë se në objektin e prokurimit janë dhe disa mallra nga të cilat cilësia jashtë standartit do të ndikonte keq në mjedis. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që produktet kanë mbi mjedisin.

- *Certifikatë për specifikimet për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit ISO 28001 – 2007. *Certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”;**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1 ,2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” . Autoriteti Kontraktor ka kërkuar këtë certifikatë për të vërtetuar se mallrat, si objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe shpreh garancinë për to. Duke qenë se lëvrimi është për një vit dhe furnizimi është çdo muaj, për arsye se disa produkte si detergjentët larës dhe klori dizifektues, janë produkte florues (avullues) dhe cilësia bie çdo muaj, në e bëjmë furnizimin çdo muaj.

Gjithashtu duke qënë se furnizimi gjatë periudhës është 10-12 herë, atëherë është i domosdoshëm Sigurimi i Zinxhirit të Furnizimit.

2.4.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë, fletë –analizë për mallrat e mëposhtme:

Nr	Emertimi
1	Detergjent pllakash dhe pajisjesh
2	Sapun Tualeti antibakterial
3	Solucion larës për lavatriçe
4	Pastrues pajisje banjo
5	Solucion enësh lëng
6	Sapun i lëngshëm
7	Detergjent pastrimi yndyrnash
8	Acid Muriatik
9	Solucion zbardhues higjenizues

(Fletët e analizës, të cilat do ti bashkangjiten dokumentave elektronikisht, të jenë të lëshuara nga institucione të autorizuar/certifikuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në neni 40, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kërkohen për të garantuar furnizimin me produkte të kontrolluara dhe çertifikuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe/ ose çdo institucion i autorizuar, pasi këto produkte janë të një përditshmërie dhe cilësia jashtë standartit mund të ndikojë negativisht në shëndetin e përdoruesve.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e meposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Qendra Ekonomike e Arsimit
Adresa Rruga “Neki Libohova”, Lagja nr.17 Durrës
Tel/Faks 052 22 34 81
E-mail gendra.ek.arsimit@hotmail.com

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Mall.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-94344-02-01-2024

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje materiale pastrimi për institucionet e QEA-s Durrës”

5. Fondi limit: 10,819,649 (dhjetë milion tetëqind nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 19.02.2024 Ora: 10:00

Njësia e Prokurimit